



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave
Ministarstvo Finansija - Ministry of Finance

Departamenti për Politika Makroekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar

Buletini Ekonomik Tremujor
Korrik - Shtator
2020

Buletini Ekonomik Tremujor ofron një përditësim të disa prej zhvillimeve kyçe brenda disa sektorëve të ekonomisë. Buletini është dizajnuar me qëllim që të jetë informativ për të gjithë lexuesit. Duke qenë se impakti negativ i pandemisë në ekonomi ka vazhduar në tremujorin e tretë, në këtë numër të buletinit gjendet një përshkrim i detajuar i treguesve duke u fokusuar edhe në ecurinë e tyre mujore për të dhënë një pasqyrë më të mirë të efekteve të pandemisë. Gjithashtu, në këtë buletin ofrohet një vlerësim i ndikimit të kësaj krize në nivelin potencial të ekonomisë. Buletini mund të përdoret për punime kërkimore ose për qëllime prezantimi, vetëm me citimin e burimit. ¹

¹ Ky Buletin merr në konsideratë informacionin që ka qenë i disponueshëm për tremujorin e tretë të 2020-ës deri në datën 22 Nëntor 2020.

Përmbajtja

Zhvillimet e Ekonomisë së Jashtme	3
Spektori Real.....	4
Rritja Ekonomike	4
Inflacioni	6
Spektori i Jashtëm.....	8
Llogaria Rrjedhëse	8
Llogaria Financiare.....	10
Spektori Financiar	11
Tregu i Punës.....	11
Regjistri i bizneseve, 2020 T3.....	12
Financat Publike	12
Të hyrat.....	12
Shpenzimet.....	13
Bilanci i përgjithshëm buxhetor.....	14
INFORMATATA TË TJERA: Ndikimi i krizës ekonomike COVID-19 në BPV-në Potenciale	14

Zhvillimet e Ekonomisë së Jashtme

Pas tremujorit të dytë i cili u ndikua më së shumti negativisht nga pandemia Covid-19, tremujori i tretë është karakterizuar me rimëkëmbje ekonomike të pjesshme në shumicën e vendeve të BE-së dhe të botës. Megjithatë, kjo rimëkëmbje është penguar në fund të këtij tremujori, për shkak të rikthimit të rasteve të infektiveve që ka bërë që pjesa dërrmuese e masave kufizuese të rikthehen.

Sipas vlerësimit të dytë paraprak, ekonomia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës gjatë tremujorit të tretë të 2020-ës në terma realë shënoi një rritje prej 33.1% krahasuar me tremujorin e kaluar dhe rënie prej 2.9% krahasuar me vitin e kaluar. Norma e papunësisë u rrit në mënyrë drastike nga 3.6% në fillim të vitit (janar) në 14.7% në muajin prill, kur edhe arriti kulmin, për të zbritur gradualisht në 7.9% në muajin shtator. Qeveria amerikane ka reaguar ndaj situatës pandemike duke ndërmarrë një paketë të konsiderueshme fiskale (rreth 15% të BPV-së), ndërkohë që Rezerva Federale e ka përkrahur ekonominë duke mbajtur norma të ulta interesi dhe duke intensifikuar programin e injektimit të likuiditetit në ekonomi.

Sipas të dhënave më të fundit të Eurostatit², ekonomia e Eurozonës dhe BE-së gjatë tremujorit të tretë të 2020-ës shënoi rënie vjetore prej 4.3% dhe 3.9%, respektivisht. Ndërsa krahasuar me tremujorin e dytë të vitit, Eurozona dhe BE-ja kanë pasur rritje prej 12.8% dhe 12.1%. Rënia nuk ka qenë e njëtrajtshme ndërmjet vendeve anëtare, nga të cilat Spanja, Portugalia dhe Çekia kanë regjistruar rënien më të madhe. Vendet si Gjermania, Zvicra, prej të cilave vijnë më shumë se 60% e remitancave në Kosovë, kanë shënuar gjithashtu turrje vjetore në tremujorin e tretë, megjithatë krahasuar me tremujorin e kaluar të dy vendet kanë shënuar rritje prej 8.2% dhe 7.2%, respektivisht. Analiza e përbërjes së Bruto Produktit Vendor sipas metodës së shpenzimeve (si në Eurozonë ashtu edhe në Bashkimin Evropian) tregon se konsumi final i popullatës ka pasur kontribut negativ në rritjen ekonomike krahasuar me tremujorin e kaluar (me rreth 2.4 p.p dhe 2.3 p.p, respektivisht), për t'u ndjekur nga eksporti (me rreth 4.2 p.p dhe 4.0 p.p, respektivisht). Edhe në tremujorin e tretë vazhdoi rënia në punësim në Eurozonë dhe Bashkim Evropian me -2.3% dhe -2.0%, respektivisht, megjithatë kjo rënie ishte më e zbutur se në tremujorin e dytë të 2020-ës.

Inflacioni, pothuajse në të gjitha vendet, ka shënuar ecuri rënese gjatë periudhës pandemike. Inflacioni në Eurozonë ka shënuar një rënie të shpejtë nga 1.1% të regjistruar në tremujorin e parë të 2020-ës në 0.2% në tremujorin e dytë dhe 0.03% në tremujorin e tretë. Ngjashëm ka qenë edhe ecuria e inflacionit në SHBA (nga 2.1% në 2020TM1 në 0.4% në 2020TM2 mirëpo në TM3 inflacioni shënoi rritje me rreth 1.2%). Presionet disinflacioniste të gjeneruara nga rënia e kërkesës agregate në kombinim me çmimet më të ulta të naftës, i kanë kompensuar apo edhe tejkaluar presionet rritëse të kostove të gjeneruara nga ç'akordimet e ofertës.

Në të njëjtën kohë, tregjet e mallrave janë goditur nga pandemia, e cila ka ndikuar si në kërkesën agregate ashtu edhe në furnizimin e mallrave. Si rrjedhojë, pas një rënie të theksuar gjatë tremujorit


² <https://ec.europa.eu/eurostat/documents/2995521/10663774/2-30102020-BP-EN.pdf/94d48ceb-de52-fcf0-aa3d-313361b761c5>

të dytë në çmimet e mallrave në tregjet ndërkombëtare³, në tremujorin e tretë kjo ecuri rënëse filloi të zbutet, edhe pse niveli i tyre qëndron ndjeshëm më poshtë se ai i shënuar në fillim të vitit.

Pavarësisht zbutjes së ecurisë rënëse për një pjesë të mirë të treguesve ekonomikë në tremujorin e tretë, ekziston ende pasiguri e lartë për pjesën e mbetur të vitit. Pasiguria kryesore lidhet me evoluimin e pandemisë, rikthimin e kufizimeve në disa shtete apo zhvillimeve në lidhje me vaksinën SARS-Cov-2. Përtej rreziqeve të lidhura me pandeminë, ekzistojnë një sërë rreziqe të tjera, si: përshkallëzimi i tensioneve ndërmjet SHBA-së dhe Kinës në disa fronte; dobësimit të marrëdhënieve ndërmjet vendeve anëtare të OPEC-it; apo trazira shoqërore në vende të ndryshme.

4

Grafiku 1 Çmimet në tregjet ndërkombëtare, %, v-m-v



Sektori Real Rritja Ekonomike

Në mungesë të të dhënave zyrtare nga ASK-ja për BPV-në për tremujorin e tretë të 2020-ës, në këtë numër të Buletinit analizohen të dhënat më të fundit të disponueshme, që i përkasin tremujorit të dytë të 2020-ës dhe më tej ofrohet një vlerësim cilësor për pritjet e aktivitetit ekonomik për tremujorin e tretë të 2020-ës.


Në tremujorin e dytë të vitit 2020, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), ekonomia e Kosovës shënoi rënie të paprecedentë me rreth 9.3% (v-m-v) në terma realë dhe me 10.3% (v-m-v) në terma nominalë. Kjo rënie shënon rënien më të ulët historike për ekonominë e Kosovës dhe përfaqëson kulmin e ndikimit negativ të pandemisë Covid-10 në ekonomi.

³ <https://www.imf.org/en/Research/commodity-prices>


⁴ <https://www.imf.org/en/Publications/WEO/Issues/2020/06/24/WEOUpdateJune2020>

Rënia reale e rritjes ekonomike në tremujorin e dytë të 2020-ës prej 9.3%, i atribuohet kryesisht të gjithë komponentëve të kërkesës agregate, me kontributin më të madh negativ të ardhur nga investimet totale (prej 14.3 p.p) dhe eksportit të shërbimeve (me kontribut negativ prej 10.5 p.p). Ndërkohë, ndryshe nga pritjet, konsumi privat shënoi kontribut pozitiv gjatë tremujorit të dytë (me rreth , si rezultat i rritjes së konsiderueshme të dërgesave të emigrantëve gjatë këtij tremujori por edhe tendencës së konsumatorëve për të rritur rezervat ushqimore (apo esenciale) për të adresuar masat e karantinimit apo mundësinë e ndërprerjeve të konsiderueshme të furnizimit. Eksporti i mallrave gjithashtu shënoi kontribut pozitiv në 2020TM2 (me rreth 0.7 p.p), kryesisht si rezultat i rritjes së eksportit të metaleve bazë. Në linjë me pritshmëritë, shpenzimet shtesë buxhetore në përgjigje të reagimit ndaj pandemisë bënë që konsumit publik të kontribuonte pozitivisht gjatë këtij tremujori (me rreth 1.1 p.p).

Grafiku 2 Kontributet në BPV



Grafiku 3 BPV reale sipas aktiviteteve, v-m-v, %



Në tremujorin e dytë të 2020-ës , bazuar në ndarjen e BPV-së sipas aktiviteteve ekonomike, sektori i vetëm që ka shënuar kontribut pozitiv në rritje reale të BPV-së ka qenë sektori i “industrisë”⁵ (me rreth 2.7 p.p.). Ndërkohë sektori i ndërtimit dhe sektori i shërbimeve⁶ janë goditur ndjeshëm nga pandemia, duke shënuar një kontribut negativ prej 5.3 p.p dhe 2.5 p.p, respektivisht. Ngjashëm me tremujorin paraprak, sektori i “ Bujqësisë, Pylltarisë dhe Peshkimit” ka shfaqur një kontribut shumë afër zeros (- 0.1 p.p).

⁵ Sektori i industrisë përfshin kategoritë: “industria nxjerrëse”, “industria përpunuese”, “furnizimi me energji elektrike dhe gaz”, dhe “furnizimi me ujë”.

⁶ Sektori i shërbimeve përfshin kategoritë: “tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave”, “transporti dhe magazinimi”; “hotelet dhe restorantet”; “informimi dhe komunikimi”, “aktivitetet financiare dhe te sigurimit”; “afarizmi me pasuri te patundshme”, “administrimi publik” dhe “shërbime të tjera”.

Pritjet për ecurinë makroekonomike për TM3 2020

Në mungesë të të dhënave zyrtare nga ASK-ja për BPV-në në tremujorin e tretë të 2020-ës, indikatorët e kërkesës agregate japin sinjale për vazhdim të rënies së konsiderueshme të aktivitetit ekonomik.

- Sinjalet për ecurinë e konsumit privat gjatë 2020T3 tregojnë një rënie krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar, mbështetur nga rënia dyshifrore e mbledhjes së TVSH-së (14.9%, $v-m-v$); rënia e importit të mallrave të konsumit me rreth 12.8% ($v-m-v$, %). Ndërkohë, kredia e re për qëllime të konsumit dhe dërgesat e emigrantëve kanë shënuar një rritje prej 37.4% dhe 18.1% në terma vjetorë.
- Konsumi publik⁷ është rritur me rreth 5.9% në tremujorin e tretë të 2020-ës ($v-m-v$). *Rritja në kategorinë e pagave dhe mëditjeve* si rezultat i implementimit të një sërë masash të Programit për Rimëkëmbje Ekonomike është zbutur paksa nga dinamika e ulët e shpenzime në mallra dhe shërbime si rezultat i aktivitetit më të ulët në administratën publike gjatë kësaj periudhe.
- Sinjalet për investimet private sugjerojnë një rikuperim të investimeve private gjatë 2020T3, mbështetur nga: *i*) rritja e lehtë e importit të mallrave kapitale me 2.6% ($v-m-v$); *ii*) rritjes së kredisë së re për qëllime të investimit me 57.8% ($v-m-v$); dhe *iii*) rritjes së numrit neto të bizneseve neto (*diferenca ndërmjet numrit të bizneseve të reja të regjistruara dhe numrit të bizneseve të shuara*) me 14.8% në terma vjetorë.
- Dinamika e investimeve publike është përshpejtuar në 2020T3 krahasuar me pjesën e parë të 2020-ës, edhe pse krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, vazhdon të jetë e dobët, duke shënuar një rënie vjetore prej 5.8% ($v-m-v$).
- Deficiti tregtar i mallrave dhe shërbimeve në tremujorin e tretë të 2020-ës është përkeqësuar ndjeshëm me rreth 142% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kryesisht si rezultat i ngushtimit të suficitit në tregtinë e shërbimeve, i cili e ka tejkaluar ngushtimin e deficitit të bilancit të mallrave.

Inflacioni

Në T3 2020, Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) shënoi rënie mesatarisht me rreth 0.35% në terma vjetorë. Kjo normë është ndjeshëm më e ulët se norma e inflacionit e regjistruar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (rreth 2.56%). Dinamika mujore e ecurisë të inflacionit ka qenë në vazhdimësi rënëse gjatë këtij tremujori, duke shënuar një normë vjetore prej -0.09%, -0.47% dhe -0.47% në muajt korrik, gusht dhe shtator 2020, respektivisht. Kjo ecuri rënëse i atribuohet më së shumti rënies së çmimeve të mallrave bazë (naftës) në tregjet ndërkombëtare dhe rënies së çmimeve të kategorisë së perimeve.

Nënkategoritë e IÇK-së që treguan rënie më të theksuar ishin:

⁷ Konsumi Publik përfshin dy kategori të shpenzimeve: “paga dhe mëditje” dhe “mallra dhe shërbime” dhe “shpenzime komunale”.

- Kategoria e “perimeve” me kontribut negativ rreth 0.10 pikë të përqindjes, duke shënuar një rënie vjetore prej 2.9%;
- Kategoria “përdorimi i pajisjeve për transportin personal” shënoi rënie të ndjeshme me rreth 14.7% dhe kontribut negativ rreth 1.15 p.p, kryesisht si rezultat i zhvillimeve të çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare.

Nënkategoritë e IÇK-së që treguan rritjen më të lartë ishin:

- Kategoria e ushqimit me një rritje vjetore prej 1.0% dhe një kontribut në inflacionin total prej 0.3 p.p, kryesisht si rezultat i rritjes së çmimit të kategorisë “buke dhe drithra” dhe “mish”.
- Ngjashëm si në tremujorin e dytë, kategoria “shëndeti” ka shënuar rritje më të theksuar se në të kaluarën me kontribut rreth 0.12 p.p. dhe rritje vjetore prej 4.9%.
- Kategoria “Mallra dhe shërbime të ndryshme” shënoi kontribut më të lartë se në tremujorin e kaluar me rreth 0.20 p.p apo rritje vjetore prej 4.2%;

Tabela 1 Kontributet e kategorive kryesore në inflacionin vjetor


Nën kategoritë kryesore të IÇK (kontributi në pikë përqindje, nëse nuk ceket ndryshe)	2018	2019				2020		
	Mes.	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3
Ushqimi dhe pijet jo-alkoolike	0.62	2.54	2.54	1.97	1.27	0.74	0.98	0.46
<i>prej të cilave: Ushqimi</i>	0.62	2.50	2.52	1.86	1.10	0.57	0.79	0.35
<i>Buka dhe Drithërat</i>	0.22	1.08	1.28	1.36	0.79	0.22	0.21	0.25
<i>Pemët</i>	-0.02	-0.20	-0.14	-0.05	0.09	0.27	0.28	0.04
<i>Perimet</i>	0.23	0.92	0.65	-0.03	-0.19	-0.44	-0.29	-0.10
Pijet alkoolike dhe duhani	0.13	0.19	0.15	0.15	0.11	0.01	0.05	0.04
<i>prej të cilave: Duhani</i>	0.09	0.11	0.12	0.09	0.08	0.02	0.02	0.07
Komunikimi	-0.04	-0.02	0.27	0.02	0.04	0.04	-0.22	0.02
Shëndeti	0.00	0.00	0.01	0.02	0.04	0.10	0.14	0.12
Hotele, Restorante, dhe Kafe	0.07	0.05	-0.11	0.02	0.03	0.08	0.27	0.07
Përdorimi i pajisjeve për transportin personal	0.50	0.40	0.25	-0.01	-0.14	-0.58	-1.37	-1.15
IÇK (v-m-v, %)	1.06	3.20	3.26	2.56	1.67	1.07	0.19	-0.35

Inflacioni bazë⁸ në tremujorin e tretë të 2020-ës, i matur duke përjashtuar kategoritë "ushqim dhe pije jo-alkoolike" dhe "transporti", shënoi një rritje vjetore prej 0.8%; ndërsa kur përjashton vetëm kategorinë “transport”, inflacioni bazë vlerësohet të jetë rreth 0.7%. që është ndjeshëm më i lartë se sa inflacioni total (0.2%) për këtë periudhë. Të dy matjet për inflacionin bazë janë më të larta se inflacioni total (mesatarisht -0.3%) në tremujor të tretë. Megjithatë, ngjashëm me inflacionin total, të dyja matjet e inflacionit bazë, shënojnë rënie krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.


⁸ Inflacioni bazë mat ndryshimin e çmimeve të produkteve të shportës së konsumatorit, duke përjashtuar luhatshmërinë e përkohshme dhe tranzitore, e cila kryesisht karakterizon kategorinë e ushqimeve apo të energjisë.

Ndryshe nga ecuria e kaluar, kontributi i komponentit të inflacionit të komponentit të patregtueshëm⁹ në 2020T3 është më i madh se kontributi i inflacionit të tregtueshëm, duke shënuar një kontribut pozitiv prej 0.29 pikë përqindje (rritje vjetore prej 1.3%)- kryesisht si rezultat i rritjes së inflacionit në kategoritë “shëndeti”; “pushime të organizuara” dhe “hotele, kafe dhe restorante”.

Grafiku 4 Inflacioni total ndaj inflacionit bazë



Grafiku 5 Kontributi i inflacionit të treg. dhe patregt.



Sektori i Jashtëm Llogaria Rrjedhëse

Deficiti tregtar i mallrave në tremujorin e tretë të vitit 2020 arriti vlerën prej 675.3 milionë € duke reflektuar një ngushtim të deficitit krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.


- Importi i mallrave gjatë tremujorit të tretë të 2020-ës shënoi një rënie vjetore prej rreth 9.2%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kontribut më të theksuar në këtë rënie shënuan kategoritë e importeve të produkteve minerale (-6.6 p.p.) dhe të artikujve ushqimorë (-1.9 p.p.).
- Eksporti i mallrave gjatë tremujorit të tretë 2020 shënoi një rritje vjetore prej 7.1%. Kjo rritje ka ardhur kryesisht nga rritja në ecurinë e eksportit të artikujve tjerë të prodhuar, me një kontribut pozitiv prej 9.4 p.p në ecurinë e eksportit total. Eksporti i produkteve të perimeve dhe eksporti i produkteve të industrisë kimike gjithashtu kishin kontribut pozitiv me (2.5 p.p.) dhe (2.1 p.p.), respektivisht. Ndërsa, kontributi i produkteve mineraleve ishte negativ me rreth 2.7 p.p.. Ky tremujor u karakterizua edhe me rënien e eksportit të metaleve bazë prej 21.7%, përkundër një përsheptimi të dukshëm në dy tremujorët e parë të vitit.

⁹ Inflacioni i tregtueshëm mat ndryshimin e çmimeve të atyre produkteve që janë të ekspozuara ndaj tregtisë në tregjet ndërkombëtare dhe rrjedhimisht çmimet e tyre nuk ndikohen nga zhvillimet në tregun lokal. Ndërsa, inflacioni i patregtueshëm mat ndryshimin e çmimeve të atyre produkteve që nuk tregtohen në tregjet ndërkombëtare dhe rrjedhimisht ndikohen nga tregu i brendshëm lokal.

Suficiti tregtar i shërbimeve për tremujorin e tretë të 2020-ës është 147.7 milionë € dhe është rreth 72.8% më i ulët se bilanci në periudhën e njëjtë të vitit 2019.

- Eksporti i shërbimeve për tremujorin e tretë të vitit 2020 ishte 59.4% më i ulët se ai në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, me kontributin kryesor negativ të ardhur nga eksporti i shërbimeve të udhëtimit (-59.2 p.p.).
- Importi i shërbimeve kishte gjithashtu rënie vjetore prej 33.9%, kryesisht si rezultat i rënies së shërbimeve të udhëtimit, të cilat kontribuuan me -28.3 p.p.
- Rënia e importit të mallrave dhe bilancit të shërbimeve ka qenë më e theksuar në tremujorin e tretë për shkak të sezonalitetit të lartë që karakterizon këtë periudhë.

Grafiku 6 Llogaria rrjedhëse




Bilanci i të ardhurave parësore për tremujorin e tretë të 2020-ës ka shënuar një rritje të theksuar prej 187.6% (17.8 mln më shumë), duke arritur një vlerë prej 41.3 milionë euro, kryesisht si rezultat i daljeve më të larta të nga kategoria e investimeve.

Bilanci i të ardhurave dytësore për këtë tremujor arriti vlerën prej 395 milionë euro, që është 14.2% më i lartë se bilanci në të

njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo rritje i atribuohet kryesisht rritjes së bilancit të transfereve të korporatave financiare, jo-financiare, dhe ekonomive familjare (13.2 %, *v-m-v*) dhe transfereve zyrtare qeveritare (19.3%, *v-m-v*).

Duke qenë se bilanci i të ardhurave dytësore dominohet nga hyrjet e remitencave, vlen të ceket se ato në këtë tremujor shënuan një rritje vjetore prej 18.1% që ishte shumë më e theksuar se sa rritja historike. Pjesëmarrja e remitencave të dërguara përmes agjencive për transfer të mjeteve u rrit me rreth 94.7% krahasuar me periudhën e njëjtë të 2019-ës. Kjo vjen si rezultat i kufizimeve të udhëtimit në mes të Kosovës dhe të vendeve të Evropës prej nga dërgohen remitencat, që ndikoi në rënien e dërgimeve përmes kanaleve tjera që janë kryesisht në formë të parave të gatshme.


Grafiku 7 Remitencat sipas kanaleve të dërgimit – TM3



Bilanci i të ardhurave parësore, bilanci i të ardhurave dytësore dhe bilanci tregtar i mallrave shënuan përmirësim gjatë këtij tremujori. Mirëpo, bilanci tregtar i shërbimeve kishte një përkeqësim i cili si rrjedhojë, bëri që bilanci i llogarisë rrjedhëse për tremujorin tretë të 2020-ës të ishte -90.9 milionë euro, që është në nivel dukshëm më të ulët se bilanci i regjistruar në periudhën e njëjtë të vitit paraprak kur bilanci i llogarisë rrjedhëse kishte vlerë prej 151.9 milionë euro.

Llogaria Financiare

Grafiku 8 Llogaria Financiare



○ Bilanci i llogarisë financiare për tremujorin e tretë të 2020-ës është zvogëluar me rreth 108.4 milionë euro, si rezultat i rënies në prurjet e investimeve të huaja direkte dhe investimeve tjera.

○ Gjatë kësaj periudhe, hyrjet totale të IHD-ve kishin një rënie prej 27% krahasuar me periudhën e njëjtë të 2019-ës. Ky zhvillim erdhi kryesisht nga rënia e IHD-ve në sektorin e patundshmërisë i cili kishte një kontribut prej -24.3 p.p. në këtë rënie.

Sektori Financiar

- Tremujori i tretë i vitit 2020 u karakterizua me një rritje të theksuar vjetore të kredive të reja prej 30.3%. Kjo reflekton rritjen prej 29.6% në kreditë e korporatave jo-financiare dhe një rritje prej 31.8% në kreditë e ekonomive familjare.
- Depozitat e reja në tremujorin e tretë shënuan një rënie vjetore prej 25%. Kjo rënie ishte e shtyrë kryesisht nga rënia e depozitave të ekonomive familjare për 20.3% dhe një rënie në depozitat e korporatave jo-financiare prej 35.1%.
- Norma efektive e interesit për kreditë e reja për tremujorin e tretë të vitit 2020 ishte mesatarisht 6.2%, ndërsa ajo për depozitat e reja ishte mesatarisht 1.4%.
- Kreditë jo-performuese gjatë tremujorit të tretë ishin 2.6% të totalit të kredive, duke treguar një përqendrim nga tremujori i tretë i vitit të kaluar (2.3%).

Tabela 2 Indikatorët e Sektorit Financiar

	2019				2020		
	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3
Depozitat e reja % Δ	0.8	22.6	-0.1	-5.9	-5.3	-40.4	-25.0
Kreditë e reja % Δ	-5.0	1.8	26.1	1.5	28.4	-47.8	30.3
Norma efektive e interesit në kredi të reja	6.7	6.4	6.4	6.4	6.4	6.2	6.2
Norma efektive e interesit në depozita të reja	1.5	1.4	1.4	1.5	1.5	1.5	1.4
Kreditë jo-performuese	2.6	2.6	2.3	2.2	2.4	2.6	2.6

Tregu i Punës

- Publikimi i rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore për 2020 T3 është shtyrë përsëri për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID19, dhe rrjedhimisht të dhënat më të fundit të disponueshme i përkasin ato të tremujorit të dytë të këtij viti.
- Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore për 2020T2, shkalla e punësimit arriti vlerën prej 24.1%. Gjatë këtij tremujori, numri e të punësuarve shënoi rënie dyshifrore prej 17.5% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kryesisht si rezultat i rënies së numrit të punësuarve në sektorin e ndërtimitarisë (-46.1%, *v-m-v*); sektorit të prodhimit (28.0%, *v-m-v*), dhe sektorit të aktiviteteve të akomodimit dhe shërbimeve të ushqimit (-42.4%, *v-m-v*).
- Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore gjithashtu ka shënuar rënie të konsiderueshme krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke u luhatur rreth vlerës 33.2%. Numri i personave në fuqinë punëtore ka rënë me rreth 15.4% në terma vjetorë.
- Numri i të papunëve ka shënuar rënie vjetore me rreth 22.6%. Shkalla e papunësisë në 2020T2 luhatej rreth vlerës 27.2%
- Duke gjykuar mbi këto statistika, mund të konstatohet se një pjese e mirë e atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë tremujorit të dytë të 2020-ës në të njëjtën kohë kanë dalë nga forca e punës. Ngjashëm, një pjesë e të papunëve kanë dalë nga forca e punës në kushtet e pamundësisë për të gjetur punë gjatë kohës së pandemisë.

Regjistri i bizneseve, 2020 T3

- Në tremujorin e tretë të vitit 2020 (TM3) gjithsej janë regjistruar 2593 ndërmarrje e cila reflekton një rritje prej 27.54% krahasuar me tremujorin paraprak, dhe një rritje prej 8.9% të ndërmarrjeve të regjistruara krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (TM3 2019).
- Prej tyre:
 - 597 biznese të reja në tregtinë me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave (25 më shumë se në 2019 T3)
 - 231 biznese të reja në sektorin e ndërtimit (14 më pak se në 2019 T3)
 - 302 biznese të reja në sektorin e prodhimit (8 më shumë se në 2019 T3)
 - 282 biznese të reja në sektorin e akomodimit dhe shërbimeve me ushqim (7 më shumë se në 2019 T3)
- Struktura e bizneseve të reja gjatë 2020T3 dominohet nga ndërmarrjet mikro (1,511 ndërmarrje). Ndërsa, 75 ndërmarrje të vogla dhe 7 ndërmarrje të mesme u regjistruan në këtë tremujor.
- Sipas prejardhjes së kapitalit, pjesa dërrmuese ishin me kapital vendor (2,580 ndërmarrje) dhe vetëm 13 prej tyre ishin me kapital të huaj dhe përbashkët.
- Numri i bizneseve të shuara gjatë 2020 T3 arriti në 310; ky numër është më i ulët se tremujori i njëjtë në vitin e kaluar (gjithsej 390 të shuara). Ndërmarrjet e shuara gjatë 2020T3 kanë qenë kryesisht nga sektori i tregtisë, transportit dhe ruajtjes, dhe sektori i prodhimit.

Financat Publike

Të hyrat

- **Të hyrat e buxhetore** gjatë tremujorit të tretë të 2020-ës, arritën në 454 milionë Euro, duke shënuar një rënie vjetore prej 13.5% krahasuar me tremujorin e tretë të vitit paraprak. Ky arkëtim paraqet një normë realizimi prej rreth 89.5% të shumës sipas buxhetit të rishikuar për këtë periudhë.
- **Të hyrat tatimore** për këtë periudhë shënuan vlerën 394.9 milionë Euro ose një rënie prej 15.4% krahasuar me tremujorin e tretë të vitit paraprak. Këto të hyra arritën 88.4% të të hyrave të parashikuara.
- **Të hyrat direkte** arritën vlerën 68.5 milionë Euro janë për 6.3% më pak në krahasim me periudhën e njëjtë e vitit të kaluar. Prej tyre,
 - Të hyrat nga Tatimi në të ardhura të Korporatave arritën 22.9 milionë (-2.5% v-m-v)
 - Të hyrat nga Tatimi në të Ardhurat Personale arritën 39 milionë Euro (-3.7% v-m-v)
 - Ndërsa të hyrat nga Tatimi në Pronë arritën vlerën prej 6.3 milionë (-23.3%v-m-v)
- **Të hyrat indirekte** në tremujorin e tretë të 2020-ës paraqesin rreth 85% të vlerës totale të të hyrave tatimore, kurse në krahasim me tremujorin e tretë të vitit të kaluar paraqesin shkallë të rënies me rreth 17.3%.
 - Të hyrat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar shënuan rënie prej 14.9 % v-m-v.

- Të hyrat nga akciza shënuan rënie prej rreth 19.2% v-m-v.

-Kurse detyrimi doganor për këtë periudhë raportuese është dukshëm më i ulët prej rreth 26.4% në krahasim me atë të vitit paraprak.

- **Të hyrat jo-tatimore** për këtë periudhë ishin rreth 50 milionë euro, me një rënie vjetore prej 15.3% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Shpenzimet


- **Shpenzimet buxhetore** për tremujorin e tretë të 2020-tës arritën vlerën prej 541 milionë euro dhe ishin rreth 11.1% më të larta se sa periudha e njëjtë e vitit të kaluar. Realizueshmëria me projeksionet e rishikuara të buxhetit është rreth 77%.

-Kategoria e shpenzimeve rrjedhëse në tremujorin e tretë të vitit 2020, arriti vlerën prej 236 milionë euro dhe kjo paraqet një shkallë të rritjes prej 4.4% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kategoria e pagave arriti vlerën prej 163 milionë euro dhe paraqet një rritje prej 7.5%, mallrat dhe shërbimet arritën vlerën 63 milionë euro, e cila vlerë në krahasim me tremujorin e tretë të vitit të kaluar paraqet një rënie prej 2%. kurse kategoria e subvencioneve dhe transferove arriti vlerën prej 198 milionë euro e cila është për 35% më e lartë se sa periudha e njëjtë krahasuese e vitit paraprak. Rritja në këto shpenzime ishte kryesisht si rezultat i akomodimit të shpenzimeve shtesë në kuadër të Programit për Rimëkëmbje Ekonomike .


-Shpenzimet kapitale në anën tjetër arritën vlerën prej 111.7 milionë euro dhe paraqesin një shkallë të rënies prej 5.8% me periudhën krahasuese.

- **Kurse Interesi** arriti vlerën prej 8.4 milionë euro për tremujorin e tretë të vitit 2020 duke shënuar rritje vjetore prej 7.1%.

Grafiku 11 Kontributet në të hyrat buxhetore



Grafiku 12 Kontributet në shpenzime buxhetore



Bilanci i përgjithshëm buxhetor

- **Deficiti i përgjithshëm sipas rregullës fiskale** në fund të tremujorit të tretë arriti në 161 milionë € apo rreth 2.4% të BPV-së.
- **Bilanci përgjithshëm bankar(neto)** në fund të tremujorit të tretë arriti vlerën prej 297 milionë euro ose 4.3% e BPV-së.

INFORMATA TË TJERA: Ndikimi i krizës ekonomike COVID-19 në BPV-në Potenciale

BPV-ja potenciale është një indikator që tregon kapacitetin optimal të operimit të ekonomisë bazuar në nivelin e kapitalit, forcën potenciale të punës, dhe nivelit të produktivitetit të këtyre faktorëve. Për të kuptuar më mirë konceptin e BPV-së potenciale, vlen të theksohet fakti se gjatë periudhave të bumit ekonomik, një ekonomi është duke operuar mbi potencialin e vet ekonomik. Ndërsa, gjatë periudhave të krizave ekonomike, një ekonomi është duke operuar nën potencialin e vet. Duke qenë se Kosova, si shumica e vendeve të tjera të botës, për momentin është duke kaluar në një periudhë të krizës ekonomike ka lindur nevoja që të bëhet një vlerësim i BPV-së potenciale për të analizuar se ku qëndron Kosova ndaj potencialit të vet ekonomik. Duhet cekur se gjatë periudhave të tilla, përveç se një ekonomi operon nën potencialin e vet ekonomi, shpesh ndodh që edhe potenciali i vet ekonomik të shënojë rënie. Për momentin kjo është duke ndodhur në botë. Arsyeja e kësaj rënie është për shkak se kapacitetet prodhuese të shumë ekonomive kanë pësuar dëmtime të përhershme. Sipas publikimit të fundit ËEO nga FMN, ka pasur një rishikim për poshtë të BPV-së potenciale botërore. Po ashtu, vlen të ceket se BPV potenciale vetëm në vendet e zhvilluara ekonomikisht pritet të bjerë për 2 për qind gjatë 2020.¹⁰

Përveç se BPV-ja potenciale në vetvete është e rëndësishme për arsyet e përmendura më lartë, ajo shpesh përdoret edhe si variabël për të gjeneruar vlerësime apo analiza tjera. Një shembull është bilanci strukturor – ku përdoret BPV potenciale, përveç variablave tjera, për të arritur tek bilanci strukturor. Gjithashtu, BPV potenciale përdoret edhe për të kuptuar më mirë presionet inflacioniste në një ekonomi duke udhëzuar vendimmarrjen e politikës monetare të një vendi. Mirëpo, përdorimi më i rëndësishëm i saj është për të kuptuar se në çfarë cikli ekonomik është ekonomia në mënyrë që politikebërësit të kuptojnë rëndësinë e ndërrmarjes së politikave (fiskale apo monetare) për t'a kthyer vendin afër nivelit potencial.

Ka disa mënyra për të bërë vlerësimin e BPV-së potenciale, sikurse përmes teknikave të filtrimit statistikor (p.sh. përmes filtrit Hodrick- Prescott), modeleve të ndryshme ekonometrike, apo edhe përmes funksionit të prodhimit (funksioni i prodhimit Cobb Douglas) ndër tjera. Gjithsesi, duhet cekur se vlerësimi i BPV-së potenciale është sfidues për shkak se nuk është një tregues i

¹⁰ World Economic Outlook, publikimi i tetorit 2020: <https://www.imf.org/en/Publications/WEO/Issues/2020/09/30/world-economic-outlook-october-2020>

observueshëm. Andaj edhe ekzistojnë shumë metoda për të vlerësuar BPV-në potenciale, të cilat shpesh herë japin rezultate të ndryshme nga njëra tjetra.

Para se të shpjegohet metodologjia dhe rezultatet për ekonominë e Kosovës, duhet theksuar se një mangësi që është vërejtur nga kalkulimi i BPV-së potenciale është mungesa e serive të gjata kohore, mungesa e të dhënave për kapital (që në këtë rast është vlerësuar duke përdorur një metodë tjetër alternative), dhe mungesa e të dhënave të detajuara për tregun e punës.

Në këtë dokument, vlerësimi i BPV-së potenciale është bërë përmes funksionit të prodhimit Cobb Douglas. Funksioni i prodhimit Cobb- Douglas i një ekonomie përmbledh marrëdhënien ndërmjet Bruto Produktit Vendor real dhe tre faktorëve të prodhimit: kapitali, punësimi dhe produktiviteti total i faktorëve.

Kapitali përfshin tokën, makineritë, ndërtesat, infrastrukturën e transportit dhe komunikimit, inventarin e lëndës së parë, dhe produktet e përfunduara (por që ende nuk janë shitur) si dhe produktet e gjysmë përpunuara. Për të përfituar treguesin e kapitalit, investimet e secilit vit i janë shtuar stokut fillestar (i cili është supozuar që zhvlerësohet me një normë prej 6 përqind në vit). Punësimi, në këtë analizë përfaqësohet nga fuqia punëtore në ekonomi. Së fundi, produktiviteti total i faktorëve (të prodhimit) (PTF) është përdorur si indikator i produktivitetit të ekonomisë. Kjo e fundit (njohur si mbetja *Solow* në literaturën e kontabilitetit të rritjes) përmbledh gjithçka që ndikon rritjen ekonomike por që nuk shpjegohet nga dy faktorët e prodhimit të lartpërmendur: puna dhe kapitali.

Prodhimi potencial i një ekonomie është prodhimi që gjenerohet kur faktorët e prodhimit shfrytëzohen maksimalisht në kushtet aktuale të përdorimit të teknologjisë. Për të arritur tek niveli potencial i këtyre faktorëve është aplikuar filtri HP për të përfituar një seri më të zbutur.¹¹

$$BPV \text{ Potenciale} = \text{Stoku i Kapitalit}^{Pjesa e kapitalit} \times \text{Fuqia punëtore}^{(1-Pjesa e Kapitalit)} \times PTF$$


Siç u cek edhe më lart, gjatë periudhave të krizave ekonomike është e pritshme që edhe BPV-ja potenciale të bjerë, duke marrë parasysh se në periudha të tilla kapacitetet prodhuese mund të dëmtohen apo të mos shfrytëzohen si duhet (kapitali mund të zhvlerësohet më shumë, mund të bjerë numri i popullsisë në moshë pune, apo produktiviteti i ekonomisë në përgjithësi mund të bjerë ndër tjera). Në bazë të këtij vlerësimi, pritet që BPV-ja potenciale të bjerë gjatë viteve 2020 dhe 2021. Si pasojë e kësaj rënie, hendeku i prodhimit (dallimi mes BPV-së reale dhe asaj potenciale) do të mbyllet në 2025 (shih Grafikon 13).

Siç mund të shihet në Grafikon 13, pjesën më të madhe të kohës, ekonomia e Kosovës është luhatur rreth kapacitetit të vet optimal. Në vitin 2014 ajo ka operuar nën kapacitetin të vet optimal si

¹¹ Vlen të ceket se është supozuar, në bazë të literaturës së konsultuar, se pjesa (apo hisja) e kapitalit është 35 përqind, që do të thotë se pjesa e punësimit mbetet 65 përqind. Për detaje shtesë rreth kalkulimeve të bëra për këtë vlerësim, ju lutem kontaktoni divizionin e Makroekonomisë në Ministrinë e Financave të Republikës së Kosovës (makroekonomia.mf@rks-gov.net)

rezultat i ngërçit politik që ka paralizuar një pjesë të mirë të ekonomisë për shkak të pasigurive të krijuara.

Grafiku 13 - Hendeku i Prodhimit në Kosovë (2010-2025)



Nga Grafiku 13 vërejmë se hendeku i prodhimit është negativ, duke shënuar vlerën 6.4 përqind gjatë 2020 dhe gradualisht mbyllet në vitin 2025. Një rënie e tillë nuk është vërejtur asnjëherë në Kosovë më parë. Andaj, në raste të tilla ndërhyrja e shtetit në ekonomi është e domosdoshme për të ruajtur kapacitetet prodhuese, gjë që ka qenë edhe një prej objektivave kryesore të stimujve fiskale të marrë nga Qeveria e Kosovës (Pakos Emergjente Fiskale dhe Ligjit të Rimëkëmbjes.

Analiza e kontributit të faktorëve të prodhimit në BPV-në potenciale gjatë periudhës 2020-2025 (Grafiku 2) tregon se prej vitit 2010 e deri në vitin 2019 faktori me kontributin më të madh në BPV-në potenciale gjithëherë e më shumë është kapitali. Ky kontribut i lartë i kapitalit është si rezultat i investimeve të larta (sidomos atyre private). Ndërsa, në vitin 2020, rezultatet tregojnë rënie e të gjithë faktorëve të prodhimit dhe kontributi i vetëm pozitiv pritet nga PTF. Arsytet për këto zhvillime janë se gjatë 2020 pritet të rritet papunësia, gjë që ndikon që faktori ‘punë’ i prodhimit të bjerë (dhe të ketë kontribut negativ në BPV-në potenciale). Tutje, për shkak që një pjesë e kapitalit ekzistues në ekonomi gjatë krizës së pandemisë bëhet e papërdorshme (shembull, kapitali i një kafiterie të mbyllur gjatë pandemisë nuk mund të përdoret nga një biznes i sektorit të ICT-së që mund të hapet në lokacionin e njëjtë), pritet që gjatë 2020 edhe faktori ‘kapital’ i prodhimit të bjerë (dhe të ketë kontribut negativ në BPV-në potenciale, njëjtë si ‘puna’). Së fundi, edhe produktiviteti i ekonomisë (apo PTF) pritet të bjerë, për shkak se gjatë 2020 sikur kapitali ashtu edhe puna nuk janë shfrytëzuar në mënyrën më efikase (puna në distancë ishte e papërshtatshme për shumë agjentë ekonomikë, mungesa e investimeve në Hulumtim dhe Zhvillim, apo edhe përdorimi i kapitalit nën nivele optimale ndër tjera). Nga vitit 2021 e deri në 2025 pritet një kontribut më i lartë i fuqisë punëtore se sa zakonisht ishte gjatë 2010-2019; një kontribut

pothuajse i njëjtë i PTF në krahasim me trendin e viteve të fundit (2016-2019); dhe një kontribut më i ulët i kapitalit në krahasim me trendin e viteve 2015-2019.

Së fundi, mund të vërehet se edhe rritja e BPV-së potenciale gjatë periudhës 2021-2025 është nën nivelin që ishte para 2020 (posaçërisht gjatë periudhës 2017-2019). Grafiku 2 tregon atë që u cek më herët – se gjatë krizave ekonomike ndodhë shpesh që kapacitetet prodhuese të dëmtohen. Në rastin e Kosovës parashihet se kapacitetet prodhuese nuk do të rikuperohen plotësisht, për shkak të krizës së rëndë që ekonomia përjetoi gjatë këtij viti.

Grafiku 14- Kontributi i Faktorëve të Prodhimit në BPV-në Potenciale, p.p

